



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOSOVARE KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA KOSOVARSKA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. (Dip.)	Nr. Prot. (Prot. No.)
DPK/DMP	03-3292/12
Stat. (Stat.)	Data (Date)
02	18.09.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SHTËRPCË/OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U ŠTRPCE/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN SHTËRPCË

Nr. regj.519/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË SHTËRPCË, gjyqtari Elmaz Zenuni, me sekretaren juridike Igballe Arifi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sreqko Staletoviq nga Brezovica, komuna e Shtërpcës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet (ligj i aplikueshëm), më datën 31.08.2012 solli:

A K T V E N D I M

I pandehuri **Sreqko Staletoviq** nga Brezovica, komuna e Shtërpcës, i lindur më 06.01.1979 në f. Vërbeshticë, me vendbanim në Brezovicë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, anëtar i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës, i gjendjes mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse, si anëtar i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës, nuk ka vepruar sipas kërkesës së Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit të dt.01.03.2012, pasi sipas Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), nuk e ka plotësuar formularin e këtij Agjensioni dhe nuk e ka deklaruar e pasurinë,

-me çka ka kryer kundërvajtjen nga 17 par.1.3 lidhur me nenin 5 al.1 të Ligjit për Deklarimin mbi Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik,

Andaj, në bazë të nenit 17 par.1.3 lidhur me nenin 5 al.1 të Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik (Ligji nr.04/L-050)

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 1.000.00 € (njëmijë Euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Banke për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata.

Dënimin e shqiptuar në të holla i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e nëse nuk e paguan në afatin e lejuar ligjor, e njëjta do t'i shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh.

Në emër të shpenzimeve të procedurës kundërvajtëse i pandehuri obligohet të paguaj shumën paushall prej 5 €, në të njëjtin afat sikurse dënimin, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka parashtruar kërkesën nr.01 2526/12 të dt.24.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Sreqko Staletoviqit nga Brezovica, komuna e Shtërpcës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 17 par 1.3 të Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin mbi prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë dhe ka propozuar që i njëjti të shpallet përgjegjes dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari e udhëhoqi procedurën kundërvajtëse dhe e dëgjoi të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet dhënë para kësar zivkate më dt.30.08.2012 ka deklaruar se - sic thotë - e ka plotësuar formularin sipas kërke-

sës së AKK-së dhe se të njëjtin në rrugë ia ka dorëzuar zyrtarit të komunës së Shtërpçës, gjegjësisht Sekretarit administrativ të Komunës së Shtërpçës dhe se nuk e ka dorëzuar në lokalet e Administratës komunale në Shtërpçë e për këtë nuk ka dëshmi se kur dhe kujt ia ka dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë për Agjencionin Kosovar kundër Korrupsionit. Gjatë marrjes në pyetje i pandehuri ka deklaruar se është e vërtetë se sekretari administrativ i komunës ma ka dorëzuar Formularin e përmendur dhe se të njëjtin të plotësuar ia kam dorëzuar po atij, emrin e të cilit nuk e di, por për fatin tim të keq nuk kam dëshmi të shkruar, mirëpo dyshoj se mund të jetë mbështjellur diku nëpër letrat e administratës, por sidoqoftë e ndjej veten përgjigjës, përfundon deklaratën e tij i pandehuri.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari mori në pyetje dëshmitarin Agron Behramin, zyrtar në Agjencionin kundër Korrupsionit, i cili në cilësinë e të autorizuarit të AKK-së në gjykatë më dt.30.08.2012 ka deklaruar se sipas nenit 4 të Ligjit 04/L-050 Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit e ka për obligim që me zyrtarët e lartë të çdo institucioni të vë kontakt kështu edhe me zyrtarët e komunës së Shtërpçës, gjegjësisht me personin zyrtar që e cakton vetë komuna. Lidhur me këtë më dt. 01.03.2012 përmes internetit edhe telefonit kemi kontaktuar me personin zyrtar Arsenije Milosavljeviqin të cilit ia kemi dërguar në tërësi dokumentacionin për deklarin e pasurisë për secilin zyrtar të lartë të komunës së Shtërpçës. Zyrtari i lartë i komunës së Shtërpçës, vijon në deklaratën e tij i autorizuari i AKK-së, më dt.02.03.2012 ua ka dërguar listën e zyrtarëve të lartë të komunës dhe e njëjta Listë është protokoluar në AKK me nr.776/12 dt.02.03.2012. Të gjithë zyrtarëve të lartë të komunës së Shtërpçës ua kemi dërguar materialet për plotësim përmes E-mailit dhe për pranimin e këtij materiali kemi pranuar konfirmimin me telefon nga zyrtari i komunës së Shtërpçës. Gjatë verifikimit të listës së deklarin të pasurisë nga ana e AKK-së kemi konstatuar se edhe Sreçko Staletoviqit, Anëtar i kuvendit komunal në Shtërpçë ia kemi parashtruar kërkesën për plotësimin e formularit përmes zyrtarit Arsenije Milosavljeviq, ndërsa i pandehuri Sreçko Staletoviq kësaj shkresë nuk iu kishte përgjigjur edhe pse sipas nenit 4, nenit 6 al.3 dhe nenit 8 të Ligjit 04/L-050, zyrtari i lartë deklarin dhe dorëzimin e formularit në afat ligjor është i obliguar ta dorëzojë personalisht ose përmes të autorizuarit të tij, gjë që i përmenduri këtë nuk e ka bërë. Nga kjo rrjedhë se formalitetet administrative apo lëshimet objektive nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e zyrtarit të lartë për ta deklaruar pasurinën e tij, përfundon deklaratën e tij i autorizuari i parashtruesit të kërkesës.

Gjykata vlerësoi provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, analizoi me kujdes Njoftimin e Agjencisë Kundërkorrupsionit dhënë përmes të E-mailit zyrtarit të komunës së Shtërpçës Arsenije Milosavljeviq dhe konfirmimin e tij përmes telefonit se e ka pranuar më dt.01.03.2012. Nga kjo është konstatuar se i pandehuri nuk i është përgjigjur fare Kërkesës së Agjencisë për të deklaruar pasurinën edhe pse kjo gjë sipas ligjit Anëtarin e Kuvendit e obligon, andaj gjykata ka konstatuar pa mëdyshje se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë.

Në bazë të të dhënave të shënuara në kërkesë, dëgjimit të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftueshme ka vërtetuar se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, për çka e shpalli përgjigjës dhe e dënoi me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të dënimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj dënimi minimal, duke llogaritur se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga ajo që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË SHTËRPCË
RI.nr.519/12 datë 31.08.2012

Sekretarja juridike

Igballe Arifi



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi të pandehurit dhe parashtruesit
Të kërkesës iu lejohet ankesa në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje
në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi,
përmes kësaj Gjykate.

Gjyqtari

Elmaz Zenuni

